

## Terma Reference Njoftim për ekspertizë

<b>Konsulenca</b>	Termet e referencës për supervisor profesional të ekipit të profesionistëve për ofrimin e shërbimeve të specializuara me fëmijë dhe të rritur
<b>Projekti</b>	Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimin cilësor të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe parandalimit dhe përgjigjes ndaj GBV-së
<b>Kohëzgjatja e projektit</b>	Maj 2024 – Prill 2025
<b>Lloji i kontratës</b>	Kontratë shërbimi
<b>Data e fillimit të punës</b>	01 Qershor 2024

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të kontrakttojë një ekspert ofrimin e sesioneve të supervizimit profesional për punonjësit e angazhuar punonjës social, infermier dhe psikolog pranë hapësirave miqësore të frekuentuara nga fëmijë dhe nëna me fëmijë, gra dhe vajza, në kuadër të projektit “Refugjatët, veçanërisht fëmijët dhe gratë, kanë akses në shërbimin cilësor të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe parandalimit dhe përgjigjes ndaj GBV-së” zbatuar në partneritetet me UNICEF dhe financim të Byrosë së Popullsisë, Refugjatëve, dhe Migracionit (PRM) e Departamenti të Shtetit të SHBA.

### Informacion i Përgjithshëm:

**Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS** (shkurtimeisht NISMA) është një organizatë jofitimprurëse, e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. NISMA është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i NISMA është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. NISMA advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbim ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

### Detyrat dhe përgjegjësitë të ekspertit

Nën mbështetjen dhe supervizimin e plotë të drejtuesit të ekipit të Nisma ARSIS, eksperti do të ketë këto përgjegjësi:

- **Hartimi i një plan veprimi mbikqyrës:** Supervisorin profesional ka përgjegjësinë për të hartuar një plan veprimi mbikqyrës për ekipin. Ky plan përfshin qëllimet specifike, aktivitetet, dhe afatet kohore për të siguruar që ekipi të punojë në përputhje me qëllimet dhe standartet e përcaktuara.
- **Mbikqyrja e dinamikës së marrëdhënieve punonjës-përfitues:** Supervisorin monitoron dinamikën e marrëdhënieve punonjës-përfitues për të siguruar një vlerësim të saktë të performancës së

ekipit. Ky proces përfshin vlerësimin e performancës së punonjësve, identifikimin e çështjeve të mundshme, dhe ndërmarrjen e masave korigjuese nëse është e nevojshme.

- **Planifikimi dhe mbajtja e takimeve me ekipin:** Supervizori planifikon dhe mban takime periodike me ekipin për të diskutuar progresin, çështjet aktuale, dhe për të zhvilluar strategjitë e punës. Këto takime janë një mundësi për të koordinuar veprimet dhe për të adresuar çështje specifike të ekipit.
- **Mbajtja e shënimeve, përgatitja e raporteve dhe komunikimi:** Supervizori mban shënime të rregullta, përgatit raporte për performancën e ekipit, dhe komunikon me stafin drejtues dhe ekipin për të raportuar për progresin, për të identifikuar çështje, dhe për të sugjeruar veprime korigjuese.
- **Ndjekja dhe sigurimi i ofrimit të shërbimit sipas standarteve:** Supervizori ndjek dhe siguron ofrimin e shërbimit në përputhje me standartet e përcaktuara. Ky përfshin identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e shërbimit dhe në përmbushjen e nevojave të klientëve.
- **Mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me drejtuesin e projektit:** Supervizori mban kontakte të vazhdueshme me drejtuesin e projektit për të raportuar për progresin dhe për të adresuar çështje të mundshme që kanë ndikim në ecurinë e shërbimit të ofruar për të moshuarit në shtëpi.

#### Kualifikimet dhe eksperiencia:

- Të këtë kryer studimet e larta në nivelin bachelor dhe master shkencor në fushën e shkencave sociale.
- Të këtë përvojë profesionale në fushë e shërbimeve sociale për një periudhë minimale pesë vjecare.
- Të këtë përvojë pune si supervisor/e në shërbime apo organizata të ndryshme.
- Të këtë një qasje të qartë pune për të punuar si pjesë e një ekipi multidisiplinar profesionistësh.
- Të këtë aftësi shumë të mira planifikimi, organizative, të menaxhimit të kohës dhe të koordinimit.
- Të këtë aftësi shumë të mira komunikuese dhe ndërpersonale.
- Të këtë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të kuptojë dhe të dakortësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS dhe Politikat të Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri.

**Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve:** Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, rregulloren e brendshme të Nisma ARSIS, kodin e sjelljes, Legjislacionin e plotë për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe çdo dokument tjetër për të cilin duhet të ketë dijeni.

**Koha e mundshme e fillimit të shërbimit është 01 qershor 2024.**

**Kohëzgjatja:** 24 ditë pune total në 12 muaj.

#### **Procedura e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar në këtë pozicion të dërgojnë në adresën e emailit:

[info@nisma-arsis.org](mailto:info@nisma-arsis.org) deri në datën **26 maj 2024**, mesnatë ose në adresën: Rr. Sali Butka, Pallati T.B.M, Hyrja 1, Tiranë, dokumentet si më poshtë:

- Letër interesi ku tregohet se si ai/ajo plotëson ose tejkalon kërkesat e percaktuara për këtë detyrë; duke përfshirë të kuptuarit e punës dhe propozimin e një plan veprimi për arritjen e rezultateve të kërkuara,
- CV të detajuar të ekspertit,
- Tre referenca (të pakten dy prej të cilave duhet të kenë lidhje me fushën sociale),
- Propozim financiar ku të përcaktohet buxheti total, në lekë, dhe tarifa ditore e kërkuar përfshirë taksat.

*Në vëmendjen tuaj që në subjekt të emailit ku dërgohet aplikimi të vendoset: Aplikim për supervisor profesional.*

*Ju lutemi, në vëmendjen tuaj që vetëm personat e përzgjedhur për intervistë do të kontaktohen.*